

BULETIN MUJOR



Modernizim i sistemit të testimeve në arsim përmes ekspertizës ndërkombëtare

Ministrja e Arsimit, Mirela Kumbaro, zhvilloi një vizitë pune në Universitetin e Kembrixhit, në kuadër të reformës për modernizimin e sistemit të testimeve dhe krijimin e Agjencisë së Shërbimeve Arsimore. Ky bashkëpunim me Universitetin e Kembrixhit synon ndërtimin e një sistemi të ri, transparent, meritokratik dhe të besueshëm. Për krijimin e kësaj agjencie, ligji për të cilën është miratuar në qeveri, synohen standardet më të larta europiane ndërsa reforma po mbështetet nga ekspertiza e Universitetit të Kembrixhit dhe partneriteti me Foundational Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim.



Ministrja Kumbaro takime të nivelit të lartë në Francë, fokus puna për Liceun Francez të Korçës

Ministrja e Arsimit Mirela Kumbaro pati një agjendë të takimeve të nivelit të lartë në Paris, në kuadër të ministerialit organizuar nga UNESCO mbi "Global Education Monitoring Report". Ministrja Kumbaro pati takime bilaterale me drejtorin e Përgjithshëm të UNESCO Khaled El-Enany, ministra e autoritete franceze në fushën e arsimit, dedikuar arsimore të nisura në Shqipëri si Liceu Francez i Korçës, një marrëveshje e përbashkët mes qeverive të dy vendeve dhe bashkëpunimi mes Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Universitetit Teknologjik të Compiègne.



Përmbillet me sukses zhvillimi i testimit ndërkombëtar PIRLS

U përbyll testimi ndërkombëtar PIRLS 2026 në 180 shkolla në të gjithë vendin. PIRLS u zhvillua nga data 10 deri në 26 mars. Ky proces i rëndësishëm, që mat aftësitë e leximit dhe nivelin e të kuptuarit të nxënësve të klasave të katërta, u realizua falë angazhimit të 4,480 nxënësve pjesëmarrës, si dhe profesionalizmit të mësuesve dhe monitoruesve që garantuan mbarëvajtjen e tij. Ky testim u administrua nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar.



Edukimin pas shkolle, prezantohet vizioni i programit

Ministria e Arsimit dhe British Council organizuan konferencën "Edukimi Pas Shkollor në Shqipëri - Politika, Standarde dhe Modele për Zhvillim Gjithëpërfshirës", ku ministrja Mirela Kumbaro prezantoi vizionin për programin pas shkolle, tashmë të mbështetur edhe me kornizë ligjore. Ky program do të sjell modele si "Shkollat e Shekullit të 21", duke zhvilluar kompetenca digjitale, mendim kritik dhe aftësi bashkëkohore. Programi synon të krijojë një mjedis të sigurt dhe frymëzues për nxënësit, për zhvillimin e aftësive dhe talenteve të tyre. Një nga qëllimet kryesore është unifikimi dhe rritja e cilësisë së aktiviteteve pas shkollës, duke eliminuar fragmentimin e programeve ekzistuese.



Investime në Arsimin e Lartë

Investimet në infrastrukturën universitare po vijojnë me projekte për përmirësimin e kushteve dhe cilësisë në arsimin e lartë. Ministrja e Arsimit, Mirela Kumbaro, inspektoi ndërtimin e pistës së atletikës dhe fushës së futbollit në Universitetin e Sporteve të Tiranës, si dhe rikonstrukcionin e Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave në Universitetin Politeknik, ku po ruhen vlerat historike dhe krijohen kushte moderne. Këto investime janë pjesë e një pakete më të gjerë që përfshin edhe Fakultetin e Arkitekturës në UPT, kampusin e Universitetit të Tiranës me 17 objekte në të shtrira kryeqytet dhe projekte në proces në universitetet e Durrësit, Elbasanit dhe Universitetin Bujqësor.



Festivali i Shkencës hyn në fazën e tretë

Edicioni i parë i Festivalit Kombëtar të Shkencës hyri në fazën e tretë të tij, ndërsa 109 projekte shkencore u prezantuan në 5 Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, produkt i punës, përkushtimit dhe potencialit krijues të nxënësve të arsimit të mesëm të lartë. Projektet më të mira nga kjo fazë do të vijojnë rrugëtimin drejt finales së Festivalit Kombëtar të Shkencës që do të zhvillohet në Tiranë.



Ndryshimi në ligj i jep zgjidhje pagesës për 6761 mësues

U miratuan në Kuvend disa ndryshime në ligjin e arsimit parauniversitar, që ndër të tjera i japin zgjidhje shqetësimit për trajtimin financiar të mësuesve të punësuar përpara hyrjes në fuqi të sistemit të Bolonjës. Me këtë ndryshim përfitojnë 6,761 mësues. Në të njëjtën linjë vijon edhe indeksimi i pagave me 2.5%, si pjesë e mbështetjes së vazhdueshme për mësuesit dhe për forcimin e cilësisë në arsim.